



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE  
KRYESIA

Nr. 361 Prot.

07.10.2016

VENDIM

Nr. 5, datë 10 tetor 2016

**Për shpalljen e organizimit të çmimeve shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë për vitin 2016**

**Drejtuar :** *Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (më tej: ASHSH); seksioneve shkencore, anëtarëve të Asamblesë së ASHSH.*

**Për dijeni:** *Sektorit të financës, sektorit të burimeve njerëzore dhe shërbimeve, sektorit të botimeve shkencore dhe bibliotekës shkencore, specialistit të marrëdhënieve me jashtë dhe komunikimeve shkencore, specialistit të IT-së.*

Në mbështetje të Ligjit nr. 9655, datë 11.12.2006, Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë, neni 4, pika dh dhe neni 13; si dhe të Rregullores Për themelimin e çmimeve vjetore shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë; për mënyrën e organizimit të konkurseve; për kriteret e zgjedhjes së fituesve dhe mënyrën e shpalljes së tyre, neni 3, neni 4, pika 2, si dhe nenet 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12:

**URDHËROJ:**

1. Shpalljen e organizimit dhe thirrjen për pjesëmarrje në edicionin e parë të Çmimeve shkencore kombëtare të Akademisë së Shkencave për vitin 2016, si më poshtë:

1.1 Çmimi *Çabej*, çmim shkencor kombëtar vjetor në fushën e shkencave shoqërore e albanologjike.

1.2 Çmimi *Radovicka*, çmim shkencor kombëtar vjetor në fushën e shkencave natyrore e teknike.

1.3 Çmimi i *karrierës akademike*, çmim shkencor kombëtar vjetor.

1.4 Çmimi i *kërkuesit të ri më të suksesshëm*, çmim shkencor kombëtar vjetor.

2. Shpallja e interesit për pjesëmarrje, mbështetur *Thirrjes për pjesëmarrje* bashkëlidhur këtij vendimi, fillon nga data 1 nëntor 2016 dhe përfundon më datën 31 dhjetor 2016.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

4. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të ASHSH dhe në tri medie të shkruara kombëtare.

5. Ngarkohet sekretaria e Kryesisë së ASHSH për shpërndarjen e këtij vendimi.

6. Ngarkohet Sekretari Shkencor i ASHSH për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

**KRYETARI**

**MUZAFER KORKUTI**

